



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 7617 prot.

Shkodër, më 10.4. 2025

VENDIM

Nr. 23, datë 08.04.2025

**“ PËR STREHIMIN EMERGJENT TË FAMILJES SH.M DHE TË FAMILJES O.H
(BANESAT SOCIALE ME QIRA TË NGRITURA PËR KOMUNITETIN ROM)”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 2, pika 25 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, i ndryshuar; VKM - së nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore; VKB-së nr. 29, datë 03.06.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfutuesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin Rom dhe “Për miratimin e Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin Rom”; VKB-së nr.21, datë 29.04.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër”; kërkesës me nr. 5840, datë 12.03.2025 të Sh.M, kërkesës me nr. 6276, datë 19.03.2025 të O.H, procesverbalit të strukturës përgjegjëse të strehimit, akt-verifikimit të grupit të punës, ngritur sipas Urdhrit nr.1734, datë 04.12.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kushteve të strehimit”, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë strehimin emergjent të familjes Sh.M dhe të familjes O.H tek Banesat Sociale me Qira të ngritura për komunitetin rom.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 38 vota

Vota Pro	38
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	08.04.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion Luli

